



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 483 Prot.

Tiranë, më datë 12.08.2025

**VENDIM**

**Nr. 445, datë 12.08.2025**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Sqj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 12.08.2025:

**VENDOSI**

1. Miratimin e Konceptit të sondazheve arkeologjike hartuar në kuadër të projektit “*Pine Residence*” - *zhvillim kompleks me funksion rezidencial dhe shërbime me 2 dhe 7 kate mbi tokë dhe 4 kate nëntokë*”, Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike “B” Durrës, me zhvillues subjekti “**Rajfi**” sh.p.k., me rekomandimin:

- Sondazhet arkeologjike të realizohen manualisht, pa përdorimin e mjeteve mekanike;

2. Investitori duhet të lidhë akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, për realizimin e sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit “*Pine Residence*” - *zhvillim kompleks me funksion rezidencial dhe shërbime me 2 dhe 7 kate mbi tokë dhe 4 kate nëntokë*” si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Rezultati i sondazheve arkeologjike do të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Joli MITROJORGJI

